Врз основа на член 427 став (1) и член 438 алинеја 9), а во врска со член 307 став (3) и член 310 став (2) од Законот за финансиски инструменти (Службен весник на Република Северна Македонија бр. 66/2024), Комисијата за хартии од вредност на Република Северна Македонија на седницата одржана на ден 05.08.2025 година го донесе следниот

**ПРАВИЛНИК[1]**
**за известување за интерно порамнување од страна на овластен депозитар и податоци кои треба да ги објави овластениот депозитар на својата интернет страница**

**Предмет на уредување**
**Член 1**

Со Правилникот за известување за интерно порамнување од страна на овластен депозитар и податоци кои треба да ги објави овластениот депозитар на својата интернет страница (во понатамошниот текст: Правилник) се пропишуваат:

- содржината, структурата, рокот и начинот на кварталното известување од страна на овластениот депозитар до Комисијата за надзор на пазарот на капитал (во понатамошниот текст: Комисијата) за обемот и вредноста на нетрговските преноси со хартии од вредност кои овластениот депозитар интерно ги порамнува надвор од системот за утврдување и/или порамнување и
- податоците кои овластениот депозитар е должен да ги објави на својата интернет страница и дневно да

Në bazë të nenit 427, paragrafi (1) dhe nenit 438, nënparagrafi 9), dhe në lidhje me nenin 307, paragrafi (3) dhe nenin 310, paragrafi (2) të Ligjit të Instrumenteve Financiare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 66/2024), Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më datë 5.8.2025 e miratoi këtë

**RREGULLORE[2]**
**për raportim për shlyerje të brendshme nga ana e depozitarit të autorizuar dhe të dhënat që duhet t'i publikojë depozitari i autorizuar në faqen e vet të internetit**

**Lëndë e rregullimit**
**Neni 1**

Me Rregulloren për raportim për shlyerje të brendshme nga ana e depozitarit të autorizuar dhe të dhënat që duhet t'i publikojë depozitari i autorizuar në faqen e vet të internetit (në tekstin e mëtejmë: Rregullore) përcaktohen:

- përmbajtja, struktura, afati dhe mënyra e raportimit tremujor nga ana e depozitarit të autorizuar deri te Komisioni i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitalit (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) për vëllimin dhe vlerën e transfereve jotregtare me letra me vlerë të cilat depozitari i autorizuar në mënyrë interne i shlyen jashtë sistemit për përcaktim dhe/ose shlyerje dhe
- të dhënat të cilat depozitari i autorizuar është i obliguar që t'i publikojë në faqen e vet të internetit dhe

---

[1] Со овој Правилник се врши усогласување со:
- Делегираната уредба 2017/391 на Европската комисија од 11 ноември 2016 година за дополнување на Регулативата 909/2014 на Европскиот парламент и на Советот во однос на регулаторните технички стандарди со кои дополнително се определува содржината на известувањето за интерно порамнување CELEX бр. 32017R0391

[2] Me këtë Rregullore kryhet harmonizim me:
- Dekretin e deleguar 2017/391 të Komisionit Evropian të 11 Nëntorit të vitit 2016 për plotësim të Rregullativës 909/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në raport me standardet teknike rregullatore me të cilat në mënyrë plotësuese përcaktohet përmbajtja e raportimit për shlyerje të brendshme CELEX nr. 32017R0391

ги обновува согласно член 310 став (1) од Законот.

### Член 2

(1) Поимите кои се употребени во овој Правилник го имаат следното значење:

1) "Закон" е Законот за финансиски инструменти;

2) "Инструкција за интерно порамнување" е инструкција од клиентот на овластениот депозитар да му стави на располагање паричен износ на примачот или да ја пренесе сопственоста на или правата од хартијата/хартиите од вредност преку евидентирање во нематеријализирана форма во регистар или на друг начин, која е порамнета од овластениот депозитар во сопствената евиденција, а не преку системот за утврдување и/или порамнување;

3) "Неуспешна инструкција за интерно порамнување" е неспроведување на порамнувањето или делумно порамнување на трансакцијата со хартии од вредност на договорениот датум од страна на страните учеснички како резултат на недостаток на хартии од вредност или парични средства, без оглед на основната причина;

4) "Трансакција со хартии од вредност" е пренос на хартии од вредност, надвор од системот за утврдување и порамнување, врз основа на договор за подарок, реализација на договор за залог, судска одлука, одлука на Народна банка во постапка на решавање на банка, вложувања на хартии од вредност како непаричен влог при основање или зголемување на основната главнина во трговски друштва и статусни промени согласно Законот за трговски друштва, распределба на хартии од вредност по завршување на постапки за стечај и ликвидација, отстапување на хартии од

për çdo ditë t'i ripërtrijë në pajtim me nenin 310, paragrafi (1) të ligjit.

### Neni 2

(1) Nocionet të cilat përdoren në këtë Rregullore kanë domethënien vijuese:

1) "Ligji" është Ligji i Instrumenteve Financiare;

2) "Udhëzim për shlyerje të brendshme" është udhëzim nga klienti i depozitarit të autorizuar që t'i vë në dispozicion pranuesit shumë parash ose t'ia transferojë pronësinë ose të drejtat nga letra/letrat me vlerë përmes evidentimit në formë të dematerializuar në regjistër ose në ndonjë mënyrë tjetër, cila është e shlyer nga depozitari i autorizuar në evidencën personale, dhe jo përmes sistemit për përcaktim dhe/ose shlyerje;

3) "Udhëzim i pasuksesshëm për shlyerje të brendshme" është moszbatimi i shlyerjes ose shlyerje e pjesërishme e transaksionit me letra me vlerë në datën e dakorduar nga ana e palëve pjesëmarrëse si rezultat i mungesës së letrave me vlerë ose mjeteve monetare, pa marrë parasysh shkakun kryesor;

4) "Transaksion me letra me vlerë" është transferi i letrave me vlerë jashtë sistemit për përcaktim dhe shlyerje, në bazë të marrëveshjes për dhuratë, realizimit të marrëveshjes së pengut, vendimit gjyqësor, vendimit të Bankës Popullore në procedurën e zgjidhjes së një banke, investimeve në letra me vlerë si investim jomonetar gjatë themelimit ose rritjes së principalit themelor në shoqëri tregtare dhe ndryshimeve statusore në pajtim me Ligjin e Shoqërive Tregtare, shpërndarjes së letrave me vlerë pas përfundimit të procedurës së falimentimit dhe likuidimit, lëshimit të letrave me vlerë gjatë jetës, me anë të trashëgimisë ose në bazë të një ligji në të cilin është paraparë detyrimi për transfer të pronësisë së letrave me vlerë;

вредност за време на живот, по пат на наследство или пак врз основа на закон во кој е предвидена обврска за пренос на сопственост на хартии од вредност;

5) “Дистрибуциски корпоративни дејствија” се корпоративни дејствија коишто се однесуваат на исплата на дивиденда, камата и главнина кај обврзниците;

6) “Капитализациски корпоративни дејствија” се корпоративни дејствија коишто се однесуваат на поделба или спојување на акциите, спојувања и други статусни промени, преземања;

7) “Привилегирани корпоративни дејствија” се корпоративни дејствија коишто се однесуваат на привилегиите кои му припаѓаат на сопственикот на хартии од вредност (на пример право на предност на купување акции).

(2) Сите други поими од овој Правилник го имаат истото значење како во Законот.

## I. Квартално известување

### Содржина и структура на кварталното известување

### Член 3

(1) Кварталното известување од член 307 став (1)- од Законот задолжително ги содржи следните информации:

а) код на државата во која е основан овластениот депозитар;

б) временски жиг на известувањето;

в) период опфатен со известувањето;

г) единствен матичен број, односно идентификатор на овластениот депозитар (LEI), доколку има;

д) контакт податоци на овластениот депозитар;

ѓ) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на инструкциите за интерно порамнување

5) “Veprime distributive korporative” janë veprime korporative të cilat i referohen pagesës së dividendës, interesit dhe principalit tek obligcionet;

6) “Veprime kapitalizimi korporative” janë veprime korporative të cilat i referohen ndarjes ose bashkimit të aksioneve, bashkimeve dhe ndryshimeve të tjera statusore, marrjes në kontroll;

7) “Veprime të privilegjuara korporative” janë veprime korporative të cilat u referohen privilegjeve që i takojnë zotëruesit të letrave me vlerë (për shembull e drejta e përparësisë së blerjes së aksioneve).

(2) Të gjitha nocionet e tjera nga kjo Rregullore e kanë domethënien e njëjtë si në Ligjin.

## I. Raportimi tremujor

### Përmbajtja dhe struktura e raportimit tremujor

### Neni 3

(1) Raportimi tremujor nga neni 307, paragrafi (1) të Ligjit, detyrimisht i përmban informacionet vijuese:

a) kodin e shtetit në të cilin është themeluar depozitari i autorizuar;

b) gjurmën e vulës kohore të raportimit;

c) periudhën e përfshirë me raportimin;

ç) numrin e vetëm të amzës, respektivisht identifikuesin e depozitarit të autorizuar (LEI), nëse ka;

d) të dhënat e kontaktit të depozitarit të autorizuar;

dh) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të udhëzimeve për shlyerje të brendshme të shlyera nga

порамнети од овластениот депозитар во периодот опфатен со известувањето;

е) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на инструкциите за интерно порамнување порамнети од овластениот депозитар во периодот опфатен со известувањето, за секој од следните видови на хартии од вредност:

- преносливи хартии од вредност од член 3 став (1) точка 15) потточка а) од Законот;

- државни должнички хартии од вредност;

- преносливи хартии од вредност од член 3 став (1) точка 15) потточка б) од Законот, со исклучок на државните должнички хартии од вредност;

- преносливи хартии од вредност од член 3 став (1) точка 15) потточка в) од Законот;

- фонд со кој се тргува на регулиран пазар или ЕТФ од член 3 став (1) точка 57) од Законот;

- удели во инвестициски фондови, со исклучок на фондови со кои се тргува на регулиран пазар или ЕТФ;

- инструменти на пазарот на пари, со исклучок на државните должнички хартии од вредност;

- емисиони квоти;

- други финансиски инструменти;

ж) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на сите инструкции за интерно порамнување порамнети од овластениот депозитар во периодот опфатен со известувањето, за секоја од следните видови на трансакции со хартии од вредност:

- купување или продавање на хартии од вредност:

- операции на управување со финансиски колатерал;

- позајмување на хартии од вредност;

- репо трансакции;

depozitari i autorizuar në gjatë periudhës së raportimit;

e) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të udhëzimeve për shlyerje të brendshme të shlyera nga depozitari i autorizuar në periudhën e përfshirë me raportimin, për secilin prej llojeve vijuese të letrave me vlerë:

- letra me vlerë të transferueshme nga neni 3, paragrafi (1), pika 15, nënpika a) të Ligjit;

- letra me vlerë shtetërore të borxhit;

- letra me vlerë të transferueshme nga neni 3, paragrafi (1), pika 15, nënpika b) të Ligjit, me përjashtim të letrave me vlerë shtetërore të borxhit;

- letra me vlerë të transferueshme nga neni 3, paragrafi (1), pika 15, nënpika c) të Ligjit;

- fondi me të cilin tregtohet në treg të rregulluar ose ETF nga neni 3, paragrafi (1), pika 57) të Ligjit;

- kuota në fondet e investimeve, me përjashtim të fondeve me të cilat tregtohet në treg të rregulluar ose ETF;

- instrumente të tregut të parave, me përjashtim të letrave me vlerë shtetërore të borxhit;

- kuota emetuese;

- instrumente të tjera financiare;

ë) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të të gjitha udhëzimeve për shlyerje të brendshme të shlyera nga depozitari i autorizuar në periudhën e përfshirë me raportimin, për secilin prej llojeve vijuese të transaksioneve me letra me vlerë:

- blerjen ose shitjen e letrave me vlerë:

- operacionet e menaxhimit me kolateral financiar;

- huazimit të letrave me vlerë;

- transaksionet repo;

- други трансакции со хартии од вредност;

з) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на сите инструкции за интерно порамнување порамнети од овластениот депозитар во периодот опфатен со известувањето, за сите наведени видови на клиенти:

- професионални вложувачи од член 91 од Законот;

- мали клиенти од член 89 став (4) од Законот;

ѕ) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на сите инструкции за интерно порамнување кои се однесуваат на пренос на парични средства порамнети од овластениот депозитар во периодот опфатен со известувањето;

и) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на сите инструкции за интерно порамнување порамнети од овластениот депозитар во периодот опфатен со известувањето, за секој овластен депозитар кој ги извршува главните функции од член 288 став (1) точка 1) од Законот во врска со нематеријализираните хартии од вредност (депозитар-издавач од член 2 став (1) точка 12) од Правилникот за постапката за поврзување на депозитари);

ј) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на сите инструкции за интерно порамнување од точките е) до з) од овој став, за секој овластен депозитар кој ги извршува главните функции од член 288 став (1) точка 1) од Законот во врска со нематеријализираните хартии од вредност (депозитар-инвеститор од член 2 став (1) точка 13 од Правилникот за постапката за поврзување на депозитари);

к) вкупната количина и вредност, изразена во денари, на неуспешните инструкции за интерно порамнување од точките ѓ) до ј) од овој став за кои порамнувањето не е

- transaksionet e tjera të letrave me vlerë;

f) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të të gjitha udhëzimeve për shlyerje të brendshme të shlyera nga depozitari i autorizuar në periudhën e përfshirë me raportimin, për të gjitha llojet vijuese të klientëve:

- investitorët profesionalë nga neni 91 i Ligjit;

- klientët e vegjël nga neni 89, paragrafi (4) të Ligjit;

g) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të të gjitha udhëzimeve për shlyerje të brendshme të cilat i referohen transferit të mjeteve monetare të shlyera nga depozitari i brendshëm në periudhën e përfshirë me raportimin;

gj) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të të gjitha udhëzimeve për shlyerje të brendshme të shlyera nga depozitari i autorizuar në periudhën e përfshirë me raportimin, për çdo depozitar të autorizuar i cili i kryen funksionet kryesore nga neni 288, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit në lidhje me letrat me vlerë të dematerializuara (depozitar-emetues nga neni 2, paragrafi (1), pika 12 të Rregullores për procedurën për lidhje të depozitarëve);

h) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të të gjitha udhëzimeve për shlyerje të brendshme nga pikat e) deri f) të këtij paragrafi, për çdo depozitar të autorizuar i cili i kryen funksionet kryesore nga neni 288, paragrafi (1) pika 1) të Ligjit në lidhje me letrat me vlerë të dematerializuara (depozitar-investitor nga neni 2, paragrafi (1), pika 13 të Rregullores për procedurën për lidhje të depozitarëve);

i) sasinë totale dhe vlerën, të shprehur në denarë, të udhëzimeve të pasuksesshme për shlyerje të brendshme nga pikat dh) deri h) të këtij paragrafi për të cilat shlyerja nuk është kryer në periudhën e përfshirë me raportimin;

извршено во периодот опфатен со известувањето;

л) стапките на инструкциите за интерно порамнување од точките ѓ) до л) од овој став за кои порамнувањето не е извршено во однос на:

- вкупната вредност, изразена во денари, на инструкциите за интерно порамнување порамнети од овластениот депозитар и неуспешните инструкции за интерно порамнување;

- вкупната количина на инструкции за интерно порамнување порамнети од овластениот депозитар и неуспешните инструкции за интерно порамнување.

(2) За целите на став (1) точки и) и ј) од овој член, доколку податоците за овластениот депозитар кој ги извршува главните функции од член 288 став (1) точка 1) од Законот во врска со нематеријализираните хартии од вредност не се достапни, ИСИН бројот се употребува како заменска вредност, преку раздвојување на податоците врз основа на првите два знака од ИСИН броевите.

(3) За конверзија на другите валути во денари се применува средниот курс на Народната банка на Република Северна Македонија, ако е достапен, кој е важечки на последниот ден од периодот опфатен со известувањето.

(4) Вкупната вредност на инструкциите за интерно порамнување од став (1) од овој член ќе се пресметуваат на следниот начин:

а) во случај на инструкција за интерно порамнување наспроти плаќање, износот за порамнување на делот во парични средства;

б) во случај на инструкција за интерно порамнување без плаќање, пазарната вредност на хартиите од вредност или, доколку таа не е достапна, номиналната вредност на хартиите од вредност.

j) normat e udhëzimeve për shlyerje të brendshme nga pikat dh) deri j) të këtij paragrafi për të cilat shlyerja nuk është kryer në raport me:

- vlerën totale, të shprehur në denarë, të udhëzimeve për shlyerje të brendshme të shlyera nga depozitari i autorizuar dhe udhëzimet e pasuksesshme për shlyerje të brendshme;

- sasinë totale të udhëzimeve për shlyerje të brendshme të shlyera nga depozitari i autorizuar dhe udhëzimet e pasuksesshme për shlyerje të brendshme.

(2) Për qëllimet e paragrafit (1), pikat gj) dhe h) të këtij neni, nëse të dhënat për depozitarin e autorizuar i cili i kryen funksionet kryesore nga neni 288, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit, në lidhje me vlerat me vlerë të dematerializuara nuk janë të disponueshme, numri ISIN përdoret si vlerë zëvendësuese përmes ndarjes së të dhënave në bazë të dy shenjave të para nga numrat ISIN.

(3) Për konvertimin e valutave të tjera në denarë, zbatohet kursi i mesëm i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse është i disponueshëm, i cili është në fuqi në ditën e fundit të periudhës së përfshirë me raportimin.

(4) Vlera totale e udhëzimeve për shlyerje të brendshme nga paragrafi (1) i këtij neni do të përllogariten në mënyrën që vijon:

a) në rast të udhëzimit për shlyerje të brendshme kundrejt pagesës, shuma për shlyerjen e pjesës në mjete monetare;

b) në rast të udhëzimit për shlyerje të brendshme pa pagesë, vlera e tregut e letrave me vlerë ose, nëse kjo nuk është e disponueshme, vlera nominale e letrave me vlerë.

(5) Пазарната вредност од став (4) точка б) од овој член се пресметува на следниот начин:

а) за финансиските инструменти од член 239 став (1) од Законот примени на тргување на места за тргување во Република Северна Македонија, вредноста се определува врз основа на просечна пондерирана цена на место на тргување постигната во последните 12 месеци пред денот на порамнување на инструкциите за интерно порамнување;

б) за финансиски инструменти примени на тргување на места за тргување во Република Северна Македонија, освен за наведените од точка а) од овој став, вредноста се определува врз основа на просечна пондерирана цена на место на тргување со најголем промет постигната во последните 12 месеци пред денот на порамнување на инструкциите за интерно порамнување;

в) за финансиски инструменти, освен за наведените од точка а) или б), вредноста се определува врз основа на цена која се пресметува преку користење на претходно утврдена методологија, одобрена од Комисијата, со која се земаат во предвид критериуми поврзани со пазарни податоци, како што се пазарните цени достапни на места за тргување или кај инвестициските друштва.

**Рок и начин на достава на кварталното известување**
**Член 4**

(1) Овластениот депозитар е должен да го достави кварталното известување од член 3 од овој Правилник во рок од десет дена од денот на завршување на кварталот на кој се однесува известувањето.

(2) Кварталното известување се доставува во електронска форма преку системот за известување на Комисијата.

(5) Vlera e tregut nga paragrafi (4), pika b) e këtij neni përllogaritet në mënyrën vijuese:

a) për instrumentet financiare nga neni 239, paragrafi (1) të Ligjit të pranuara për tregtim në vende tregtimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, vlera përcaktohet në bazë të çmimit mesatar të ponderuar në vendin e tregtimit i arritur në 12 muajt e fundit para ditës së shlyerjes së udhëzimeve për shlyerje të brendshme;

b) për instrumente financiare të pranuara për tregtim në vende tregtimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përveç për të përmendurat nga pika a) e këtij paragrafi, vlera përcaktohet në bazë të çmimit mesatar të ponderuar në vendin e tregtimit me qarkullimin më të madh të arritur në 12 muajt e fundit para ditës së shlyerjes së udhëzimeve për shlyerje të brendshme;

c) për instrumente financiare, përveç për të përmendurat nga pika a) ose b), vlera përcaktohet në bazë të çmimit, i cili përllogaritet përmes përdorimit të metodologjisë së përcaktuar më parë, e miratuar nga Komisioni, me të cilën merren parasysh kriteret e lidhura me të dhënat e tregut, siç janë çmimet e tregut të disponueshme në vendet e tregtimit ose tek shoqëritë e investimeve.

**Afati dhe mënyra e dorëzimit të raportimit tremujor**
**Neni 4**

(1) Depozitari i autorizuar është i obliguar që të dorëzojë raportimin tremujor nga neni 3 i kësaj rregulloreje brenda dhjetë ditësh nga dita e përfundimit të tremujorit të cilit i referohet raportimi.

(2) Raportimi tremujor dorëzohet në formë elektronike përmes sistemit për raportim të Komisionit.

## II. Содржина на податоците кои овластениот депозитар е должен да ги објави на својата интернет страница

### Јавност на податоците
### Член 5

(1) Овластениот депозитар е должен да поседува функционална и прегледна интернет страница на која се објавуваат податоците за:

а) издавањето, замената и бришењето на нематеријализираните хартии од вредност во регистарот на нематеријализирани хартии од вредност;

б) сите нематеријализирани хартии од вредност запишани во регистарот на нематеријализирани хартии од вредност;

в) корпоративни активности кои се вршат преку овластениот депозитар;

г) идентитетот на имателите на први десет сметки на кои се евидентирани најголемата количина на било која хартија од вредност и податоци за количината на хартиите од вредност на тие сметки (во апсолутни и релативни показатели).

(2) Податоците од став (1) од овој член мора да бидат јавно достапни и ажурирани на дневна основа од страна на овластениот депозитар.

(3) Почетната интернет страница на овластениот депозитар мора да има јасно видливи и лесно достапни кратенки до податоците од став (1) од овој член.

## II. Përmbajtja e të dhënave të cilat depozitari i autorizuar është i obliguar që t'i publikojë në faqen e vet të internetit

### Publiciteti i të dhënave
### Neni 5

(1) Depozitari i autorizuar është i obliguar të posedojë faqe interneti funksionale dhe të qartë në të cilën publikohen të dhënat për:

a) emetimin, zëvendësimin dhe fshirjen e letrave me vlerë të dematerializuara në Regjistrin e letrave me vlerë të dematerializuara;

b) të gjitha letrat me vlerë të dematerializuara të regjistruara në Regjistrin e letrave me vlerë të dematerializuara;

c) aktivitete korporative të cilat kryhen përmes depozitarit të autorizuar;

ç) identitetin e mbajtësve të dhjetë llogarive të para në të cilat janë të evidentuara sasia më e madhe e cilësdo letre me vlerë dhe të dhënat për sasinë e letrave me vlerë të atyre llogarive (në indikatorë absolut dhe relativ).

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jenë të disponueshme publikisht dhe të përditësuara në bazë ditore nga ana e depozitarit të autorizuar.

(3) Faqja fillestare e internetit e depozitarit të autorizuar duhet të ketë shkurtesa qartë të dukshme dhe lehtë të aksesueshme deri në të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni.

**Член 6**

Податоците од член 5 став (1) точка а) од овој Правилник задолжително содржат:

а) општи податоци за издавачот (фирма, седиште и единствен матичен број на субјектот);

б) ИСИН број на хартиите од вредност кои се издаваат, заменуваат или бришат;

в) основ за издавањето, замената или бришењето на хартиите од вредност;

г) податоци за вкупниот број на издадени, заменети или избришани хартии од вредност;

д) датум на издавањето, замената или бришењето на хартиите од вредност;

ѓ) податоци за вкупниот број на хартии од вредност на издавачот по спроведување на издавањето, замената или бришењето на хартиите од вредност.

**Neni 6**

Të dhënat nga neni 5, paragrafi 1, pika a) të kësaj rregulloreje detyrimisht përmbajnë:

a) të dhënat e përgjithshme për emetuesin (firma, selia dhe numri i vetëm i amzës i subjektit);

b) numrin ISIN të letrave me vlerë të cilat emetohen, zëvendësohen ose fshihen;

c) bazën për emetimin, zëvendësimin ose fshirjen e letrave me vlerë;

ç) të dhënat për numrin total të letrave me vlerë të emetuara, të zëvendësuara ose të fshira;

d) datën e emetimit, zëvendësimit ose fshirjes së letrave me vlerë;

dh) të dhënat për numrin total të letrave me vlerë të emetuesit pas zbatimit të emetimit, zëvendësimit ose fshirjes së letrave me vlerë.

**Член 7**

Податоците од член 5 став (1) точка б) од овој Правилник задолжително содржат:

а) општи податоци за издавачот (фирма, седиште и единствен матичен број на субјектот);

б) основ за издавањето на хартиите од вредност;

в) податоци за вкупниот број на издадени хартии од вредност;

г) ИСИН број и ЦФИ код на хартиите од вредност;

д) номинална вредност по хартија од вредност;

ѓ) вкупен номинален капитал;

е) датум на запишувањето на хартиите од вредност.

**Neni 7**

Të dhënat nga neni 5, paragrafi (1), pika b) të kësaj rregulloreje detyrimisht përmbajnë:

a) të dhënat e përgjithshme për emetuesin (firma, selia dhe numri i vetëm i amzës i subjektit);

b) bazën për emetimin e letrave me vlerë;

c) të dhënat për numrin total të letrave me vlerë të emetuara;

ç) numrin ISIN dhe kodin CFI të letrave me vlerë;

d) vlerën nominale për çdo letër me vlerë;

dh) kapitalin total nominal;

e) datën e regjistrimit të letrave me vlerë.

## Член 8

Податоците од член 5 став (1) точка в) од овој Правилник задолжително содржат:

а) општи податоци за издавачот за кого се спроведува корпоративната активност (фирма, седиште и единствен матичен број на субјектот);

б) вид на корпоративна активност која се спроведува (дистрибуциски корпоративни дејствија, капитализациски корпоративни дејствија или привилегирани корпоративни дејствија);

г) ИСИН број на хартиите од вредност за кои се спроведува корпоративната активност;

г) датум на спроведување на корпоративната активност.

## Neni 8

Të dhënat nga neni 5, paragrafi (1), pika c) të kësaj rregulloreje detyrimisht përmbajnë:

a) të dhënat e përgjithshme për emetuesin për të cilin zbatohet aktiviteti korporativ (firma, selia dhe numri i vetëm i amzës i subjektit);

b) llojin e aktivitetit korporativ i cili zbatohet (veprime distributive korporative, veprime kapitalizimi korporative ose veprime të privilegjuara korporative);

c) numrin ISIN të letrave me vlerë për të cilat zbatohet aktiviteti korporativ;

ç) datën e zbatimit të aktivitetit korporativ.

## Член 9

Податоците од член 5 став (1) точка г) од овој Правилник задолжително содржат:

а) ознака (ИСИН) на издавачот;

б) име и презиме/назив на сопственикот на хартии од вредност;

в) процентуално учество во вкупниот број на издадени хартии од вредност;

г) процентуално учество во акциите со право на глас;

д) состојба (број) на хартиите од вредност на датум;

ѓ) вид на сметка.

## Neni 9

Të dhënat nga neni 5, paragrafi (1), pika ç) të kësaj rregulloreje detyrimisht përmbajnë:

a) mbishkrimin (ISIN) e emetuesit;

b) emrin dhe mbiemrin/emërtimin e zotëruesit të letrave me vlerë;

c) pjesëmarrjen procentuale në numrin total të letrave me vlerë të emetuara;

ç) pjesëmarrjen procentuale në aksionet me të drejtë vote;

d) gjendjen (numri) e letrave me vlerë në datë;

dh) llojin e llogarisë.

**Преодни и завршни одредби**

**Член 10**

(1) Овој Правилник влегува во сила 8 дена од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија, а ќе се применува со денот на почеток на примена на Законот за финансиски инструменти“.

(2) Обврската за достава на кварталното известување од член 3 од овој Правилник започнува од првиот квартал 2027 година.

**Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

**Neni 10**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse do të zbatohet me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit të Instrumenteve Financiare.

(2) Detyrimi për dorëzim të raportimit tremujor nga neni 3 i kësaj rregulloreje, fillon nga tremujori i parë i vitit 2027.

**Број 01-412/5**
**Скопје, 05.09.2025 година**

**Numër 01-412/5**
**Shkup, 5.9.2025**

**Комисија за хартии од вредност на Република Северна Македонија**
**Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut**
**Претседател/Kryetarja**
**Mr. Bujare Abazi**